



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA MALËSI E MADHE
KËSHILLI

Nr. 2252/12 Prot.

Koplik, me 01/08/2022

VENDIM

NR 35 , DATË 31 / 08 / 2022

PËR

**“ DETAJIMIN E SHITESËS SË FONDIT AKORDUAR SIPAS AKTIT NORMATIV
NR.12 DATË 29.07.2022 “**

Këshilli Bashkiak në mbledhjen e tij të datës 31/08/2022 me propozim të Kryetarit të Bashkisë, mbështetur në ligjin nr.9936 datë 26.06.2008 “Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë“, të ndryshuar, në ligjin nr. 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore“, të ligjit nr.68/2017“ Për Financat e vetëqeverisjes Vendore “në ligjin 115/2021 “Për buxhetin e Shtetit të vitit 2022“ i ndryshuar, në Vendimin e KB nr.70 datë 29.12.2021“Për Miratimin e Buxhetit të vitit 2022 dhe Programit Buxhetor Afatmesem 2022-2024 të Bashkisë Malësi e Madhe“; në kërkesen nr.1874 datë 24.06.2022 të Bashkisë Malësi e Madhe për shtesë të Buxhetit për vitin 2022 , në shkresën e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë me nr.14405/8 Prot.datë 05.08.2022 , mbi zbatimin e Aktit Normativ nr.12 datë 29.07.2022 për detajimin e shtesës së fondeve për njesitë e vetëqeverisjes vendore në transferen e pakushtezuar dhe transferen e pakushtezuar sektoriale, Bashkisë Malësi e Madhe i është akorduar fondi në programin 9120 (Arsimi parashkollor) llogaria ekonomike 6040000 në vlerë 6,000,000 lekë dhe në programin 03280 Sherbimi i mbrojtjes nga zjarri (PMNZSH) llogaria ekonomike 6040000 në vlerë 4,000,000 lekë,

VENDOSI

1. Detajimin e shtesës së fondit për paga për arsimin parashkollor dhe për shërbimin e mbrojtjes nga zjarri(PMNZSH) si me poshtë:

Pakesime:

Gr.00 Kap.01 Prog.09120 Llog.ekonomike 6040000 (Arsimi parashkollor) - 6,000,000 leke

Gr.00 Kap.01 Prog.03280 Llog.ekonomike 6040000 (Sherbimi i mbrojtjes nga Zjarri, (PMNZSH) - 4,000,000 leke



Shtese:

Gr.00 Kap.01 Prog.09120 Llog.ekonomike 6000000 (Paga)+6010000 (sigurime shoqerore
Arsimi parashkollor)

Paga Llog.ekonomike 6000000 + 5,141,388 leke

Sigurime shoqerore Llog.ekonomike 6010000 + 858,612 leke

Shuma + 6,000,000 leke

Gr.00 Kap.01 Prog.03280 Llog.ekonomike 6000000 (Paga) + 6010000 (sigurime shoqerore
Sherbimi i mbrojtjes nga Zjarri, (PMNZSH) +

Paga Llog.ekonomike 6000000 + 3,427,592 leke

Sigurime shoqerore Llog.ekonomike 6010000 + 572,408 leke

Shuma + 4,000,000 leke

2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari i Bashkisë.
3. Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të nenit 55 pika 6 të ligjit nr. 139/2015 "Për Veteqeverisjen Vendore",

KRYETAR

Ilir Halaj

SEKRETAR

Emirjan Hasmujaj

Miratur me 31.08.2022

Vota Pro 21

Vota Kunder 0

Vota Abstenim 0

Zbardhur me datë 01.9.2022





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA MALËSI E MADHE
DREJTORIA E FINANCES DHE BUXHETIT
SEKTORI I BUXHETIT

Nr. 2252 / Prot. 11

Koplik, me 26/08 /2022

PROJEKT-VENDIM

NR. ____, DATË ____/____/2022

PER

**“ DETAJIMIN E SHITESES SE FONDIT AKORDUAR SIPAS AKTIT
NORMATIV NR.12 DATE 29.07.2022 “**

Keshilli Bashkiak ne mbledhjen e tij te dates ____/____/2022 me propozim te kryetarit te Bashkise, mbeshtetur ne ligjin nr.9936 date 26.06.2008 “Per Menaxhimin e Sistemit Buxhetor ne Republiken e Shqiperise“, te ndryshuar, ne ligjin nr. 139/2015 “Për Veteqeverisjen Vendore“, te ligjit nr.68/2017“ Per Financat e veteqeverisjes Vendore “ne ligjin 115/2021 “Per buxhetin e Shtetit te vitit 2022“ i ndryshuar, ne Vendimin e KB nr.70 date 29.12.2021“Per Miratimin e Buxhetit te vitit 2022 dhe Programit Buxhetor Afatmesem 2022-2024 te Bashkise Malesi e Madhe“; ne kerkesen nr.1874 date 24.06.2022 te Bashkise Malesi e Madhe per shtese te Buxhetit per vitin 2022 , ne shkresen e Ministrise se Financave dhe Ekonomise me nr.14405/8 Prot.date 05.08.2022 , mbi zbatimin e Aktit Normativ nr.12 date 29.07.2022 per detajimin e shteses se fondeve per njesite e veteqeverisjes vendore ne transfertin e pakushtezuar dhe transfertin e pakushtezuar sektoriale, Bahkise Malesi e Madhe i eshte akorduar fondi ne programin 9120 (Arsimi parashkollor) llogaria ekonomike 6040000 ne vlere 6,000,000 leke dhe ne programin 03280 Sherbimi i mbrojtjes nga zjarri (PMNZSH) llogaria ekonomike 6040000 ne vlere 4,000,000 leke,

PROPOZOJ

1.Detajimin e shteses se fondit per paga per arsimin parashkollor dhe per sherbimin e mbrojtjes nga zjarri(PMNZSH) si me poshte:

Pakesime:

Gr.00 Kap.01 Prog.09120 Llog.ekonomike 6040000 (Arsimi parashkollor) - 6,000,000 leke

Gr.00 Kap.01 Prog.03280 Llog.ekonomike 6040000 (Sherbimi i mbrojtjes nga Zjarri, (PMNZSH) - 4,000,000 leke



Shtese:

Gr.00 Kap.01 Prog.09120 Llog.ekonomike 6000000 (Paga)+6010000 (sigurime shoqerore
Arsimi parashkollor)

Paga Llog.ekonomike 6000000

+ 5,141,388 leke

Sigurime shoqerore Llog.ekonomike 6010000

+ 858,612 leke

Shuma

+ 6,000,000 leke

Gr.00 Kap.01 Prog.03280 Llog.ekonomike 6000000 (Paga) + 6010000 (sigurime shoqerore
Sherbimi i mbrojtjes nga Zjarri, (PMNZSH) +

Paga Llog.ekonomike 6000000

+ 3,427,592 leke

Sigurime shoqerore Llog.ekonomike 6010000

+ 572,408 leke

Shuma

+ 4,000,000 leke

2.Per zbatimin e ketij vendimi ngarkohet Kryetari i Bashkise.

3.Ky vendim hyn ne fuqi 10 dite pas shpalljes.

KRYETARI

TONIN MARINAJ



Dt. 10.08. 2022

Nr. 2252 prot



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E FINANCËVE DHE EKONOMISË
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E BUXHETIT
DREJTORIA E FINANCËVE VENDORE

Nr. 14405/8 Prot.

Tiranë, më 5.08.2022

Lënda: Mbi zbatimin e Aktit Normativ nr. 12, datë 29.07.2022.


DEGËS SË THESARIT _____

DREJTORISË SË PËRGJITHSHME TË THESARIT

✓ BASHKISË Malësi e Madhe ✓

Në zbatim të Aktit Normativ nr. 12, datë 29.07.2022 "Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr.115/2021, "Për buxhetin e vitit 2022", të ndryshuar, të Udhëzimit nr. 9, datë 20.03.2018, të ministrit të Financave dhe Ekonomisë, "Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit", të Udhëzimit Plotësues nr. 1, datë 10.01.2022, të ministrit të Financave dhe Ekonomisë, "Për zbatimin e buxhetit të vitit 2022", miratojmë detajimin e shtesës së fondeve për njësitë e vetëqeverisjes vendore në transfertën e pakushtëzuar dhe transfertën e pakushtëzuar sektoriale, sipas strukturave në tabelën bashkëlidhur, në lekë.

SEKRETARI I PËRGJITHSHËM



Mbi zbatimin e Aktit Normativ nr. 12, datë 29.7.2021 "Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr.115/2021, "Për buxhetin e vitit 2022", të ndryshuar.

Ent Qev	Min Linj	Kod Inst	Emër Institucioni	Kap	Program	Emër programi	Llog ekon	Kod thesari	Shuma
Shtohet									
103	00	2103001	Bashkia Bulqizë	01	04960	Transferata e pakushtezuar	6040000	0603	10,000,000
166	00	2166001	Bashkia Kamëz	01	09120	Arsimi parashkollor	6040000	3535	25,000,000
130	00	2130001	Bashkia Malësi e Madhe	01	09120	Arsimi parashkollor	6040000	3323	6,000,000
141	00	2141001	Bashkia Shkodër	01	09120	Arsimi parashkollor	6040000	3333	7,000,000
130	00	2130001	Bashkia Malësi e Madhe	01	03280	Shërbimi i mbrojtjes nga zjarri (PMNZSH)	6040000	3323	4,000,000
111	00	2111001	Bashkia Fier	01	03280	Shërbimi i mbrojtjes nga zjarri (PMNZSH)	6040000	0909	6,000,000
Total									58,000,000





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA MALËSI E MADHE

Nr. 1376 Prot.

Koplik, me: 26.06.2022

Lënda : Kerkesë për Shtesë të Buxhetit për vitin 2022

Ministrit të Financave,

Ministrit Znj. Delina Ibrahimaj

E Nderuar Znj. Ibrahimaj,

Pas ndarjes së re territoriale Bashkia Malësi e Madhe tashmë përfshin një territor me një sipërfaqe prej 951.01 km², dhe një popullsi prej rreth 54 115 banorë banorë të regjistruar. Bashkia e Malësi e Madhe ka në përbërjen e saj 6 njësi administrative: Koplik, Gruemirë, Kastrat, Shkrel, Qendër, dhe Kelmend. Ajo ka nën administrimin e saj dy qytete koplik dhe Bajzë dhe 56 fshatra.

Ne zbatim të ligjit të ri nr.139/2015 "Per Veteqeverisjen vendore" ne vitin 2016 Bashkise i jane transferuar 5 funksione te reja, si me poshte:

1. Shërbimi i mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimi (MZSH)
2. Personeli mësimor dhe jomësimor në arsimin parashkollor dhe personeli jomësimor në arsimin parauniversitar.
3. Rrugët rurale
4. Administrimi i pyjeve
5. Ujitja dhe Kullimi.

Bashkia Malësi e Madhe është gjendur në vështirësi të mëdha në ofrimin e shërbimit për funksionet e reja të transferuara pasi fondet e akorduara si dhe numri i punonjësve kanë qenë të pamjaftueshme.

Më konkretisht:

1. Shërbimi i mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimi (MZSH)

Aktualisht në Bashkinë Malësi e Madhe operon një Shërbim Zjarrëfikës me 22 punonjës, duke mos përmbushuar as kufirin minimal të personelit që duhet të jetë.



Për vitin 2022 janë akorduar 25 100 131 leke dhe kërkojmë një shtesa në buxhetin e vitit 2022 për një numër punonjësish prej 6 vetë duke kjo për të kompletuar strukturën e nevojshme prej 28 punonjësish. Kjo për arsye që të mbulojmë me shërbim sipërfaqen e madhe dhe një relief të thyer, një shpërndarje të gjërë të popullsisë, shtëpi banimi, institucione arsimore, qendra shëndetsore, sipërfaqe rreth 62 hektar pyje dhe kullota që janë burim i zjarrëve, prania e disa Institucioneve të tjera të rëndësishme si : Funksionimi i tre Doganave në territorin e Malësisë së Madhe (Dogana e Vermoshit, Hani të Hotit, Grabomit), Stacioni Ndërkombëtar hekurudhor me qender në Bajzë, Burgut në Njesinë Administrative Shkrel, si dhe duke pasur parasysh që Kopliku është një ndër vendet ku janë rregjistruar temperaturat më të larta sipas Institutit Meteorologjik Shqiptar;

Gjithashtu, duke qënë se reparti i zjarrëfikësave nuk përmbush standartet minimale është e domosdoshme rikonstrukcioni i godinës dhe pajisja me mjetet e nevojshme.

Fondi shtesë që ne kërkojmë për vitin 2022 të ketë një shtesë të paktën 6 000 000 leke.

2. Personeli mësimor dhe jomësimor në arsimin parashkollor dhe personeli jomësimor në arsimin parauniversitar.

Për vitin 2022 janë akorduar 57 193 376 leke.

Aktualisht bashkia jonë nuk disponon një Çerdhe publike, kjo shkakton një handicap të madh për vete qytetin e Koplikut dhe jo vetëm. Mungesa e saj përben problem social për shkak se shumë punonjës publik apo privat detyrohen të nderpresin marrëdhëniet me punën për kujdesin e fëmijëve deri në moshën e kopshtit.

Në lidhje me këtë funksion janë gjithsejt personel mbështetës 5 roje dhe 8 pastruesë ndërkohë që kemi gjithsejt rreth 50 shkolla ku në shumicën prej tyre nuk kemi fare as roje as pastrues duke qënë një problem i vazhdueshëm si për higjenën e këtyre shkollave ashtu edhe për sigurinë në këto shkolla, prandaj kërkohet shtesë fondesh dhe personeli ndihmës për mbulimin e këtij funksioni tashmë të transferuar pranë bashkisë.

Fondi shtesë që ne kërkojmë për vitin 2022 të jetë të paktën 9 000 000 leke.

3. Rrugët rurale

Për vitin 2022 janë akorduar 13 945 020 lekë për mbulimin e pagave, sigurimeve shoqërore, shpenzime operative dhe investime për mbulimin e këtij funksioni. Bashkia ka në administrim të saj rreth 700 km rrugë rurale, kryesisht të paasfaltuara. Këtu përfshihen segmente rrugore malore si psh Rruga Goraj-Budishë-Kastrat -Rapshe me gjatësi 11 km, Rruga Tamare -Vukël - Nikç me gjatësi 18 km, Rruga e Kalces, Rruga e Lëpushës etj.

Duke patur parasysh terrenin dhe gjëndjen e këtyre segmenteve rrugore, gjatësinë e këtyre rrugëve si dhe mungesën e mjeteve fondet janë fare të pamjaftueshme për ofrimin e këtij funksioni, prandaj kërkohet një shtesë fondesh për këtë funksion për të ofruar një nivel të pranueshëm shërbimi.

Fondi shtesë që ne kërkojmë për vitin 2022 të jetë të paktën 20 000 000 leke.



4. Administrimi i Pyjeve

Për vitin 2022 janë akorduar 117 694 177 leke. Bashkia Malësi e Madhe ka një sipërfaqe prej 40.661 hektar pyje dhe 10.498 hektar livadhe, dhe rreth 11 000 hektar kullota me sipërfaqe totale rreth 62.000 Hektar.

Bazuar nga sa më sipër ka një mungesë të theksuar si në fonde ashtu edhe në personel për ofrimin e këtij shërbimi, prandaj nevojitet një shtesë personeli dhe fondesh për mbulimin e këtij funksioni. Mbrojtja e pyjeve dhe kullotave nga semundjet e ndryshme është emergjente dhe e domosdoshme, prandaj duhen bërë investime në këtë drejtim.

Fondi shtesë që ne kërkojmë për vitin 2022 të jetë të paktën 6 000 000 leke.

5. Infrastruktura e Ujitjes dhe Kullimit:

Për vitin 2022 janë akorduar 13 878 209 leke. Infrastruktura e Ujitjes dhe Kullimit përbehet nga 59 kanale ujtese dytesore me gjatësi prej 133.2 km dhe lagin një sipërfaqe prej rreth 8430 Ha. dhe 43 kanale kulluese me gjatësi 421 km dhe kullojnë 8190 Ha.

Aktualisht ne kemi gjëndje vetëm një mjet për mbulimin e këtij funksioni, i cili ka të domosdoshëm mjetin terheqës dhe transportues për të punuar. Tokat bujqësore po vuajnë thatesirën dhe mungesën kanleve ujtese, prandaj duhet vazhduar me tej me ndertimin e kanleve ujtese dhe kulluese për të mundësuar rritjen e fuqisë prodhuese bujqësore dhe blegtorale.

Bazuar në të dhënat e mësipërme vërehet se ka një mungesë të theksuar si në fonde ashtu edhe në personel për mbulimin e këtij shërbimi prandaj nevojitet shtesë fondesh dhe personelit për mbulimin e këtij funksioni të deleguar pranë Bashkisë sonë.

Fondi shtesë që ne kërkojmë për vitin 2022 të jetë të paktën 6 000 000 leke.

Bazuar nga sa më sipër për të bërë të mundur ofrimin optimal të shërbimit për funksionet e reja të transferuara kërkojmë shtesë fondesh dhe personelit për përmirësimin dhe rritje të shërbimeve të këtyre funksioneve me një fond prej rreth 47 000 000 leke.

Faleminderit për Bashkëpunimin!

KRYETAR BASHKIE

TONIN MARINAJ

